



# PLANI I BIZNESIT

2024-2026

Tetor 2023



# Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive	3
1. Rreth KMDK-së	4
2. Deklarata e politikës	5
2.1 Vizioni dhe Misioni	6
3. Veprimtaria e kompanisë	7
4. Kufizimet dhe rreziqet	8
5. Orientimi strategjik	10
6. Objektivat e KMDK-së	12
7. Sfidat	13
8. Analiza SWOT	14
9. Organogrami aktual	15
9.1 Nr. i të punësuarve & strukt. gjinore	16
10. Menaxhimi i burimeve njerëzore	17
10.1 Rekrutimi i stafit	18
11. Projektioni për Sasitë 2024-2026	19
12. Projektioni financiar	22

## Shkurtesat

<b>AER</b>	Agjencia Evropiane për Rindërtim
<b>AMMK</b>	Agjencioni për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës
<b>BE</b>	Bashkimi Evropian
<b>BD</b>	Bordi i Drejtorëve
<b>DS</b>	Deponi Sanitare
<b>KA</b>	Komisioni i Auditimit
<b>KE</b>	Kryeshefi Ekzekutiv
<b>KfW</b>	Banka Gjermane për Zhvillim
<b>KMDK</b>	Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë
<b>KRM</b>	Kompani Regjionale të Mbeturinave
<b>LM</b>	Ligji për Mbeturina
<b>LNP</b>	Ligji për Ndërmarrjet Publike
<b>ME</b>	Ministria e Ekonomisë
<b>MINT</b>	Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
<b>MMPHI</b>	Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
<b>NJPMNP</b>	Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
<b>SDG</b>	Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm
<b>TIK</b>	Teknologjia Informative dhe e Komunikimit

Plani i Biznesit (PB) është një udhërrëfyes strategjik për Kompaninë për periudhën 2024-2026. Ky dokument përcakton vizionin, misionin, objektivat dhe rezultatet e pritshme të operacioneve të Kompanisë. Plani është përpiluar në përputhje me nenin 17 të Ligjit Nr. 04/L-111, i cili ndryshon dhe plotëson Ligjin nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike dhe është në përputhje me kornizën ligjore që rregullon menaxhimin e integruar të mbeturinave në nivelet qendrore dhe komunale, me fokus në menaxhimin e deponive sanitare në Republikën e Kosovës.

Ekzekutimi me sukses i këtij plani varet nga implementimi i strategjisë së dyfishtë financiare: kompania synon së pari të jetë kryesisht e vetëfinancuar për zhvillimin e operacioneve të veta duke shfrytëzuar të ardhurat vetanake. Kurse për segmentet që përfshijnë investime të konsiderueshme dhe realizimin e strategjive kombëtare, kërkohet mbështetje e jashtme financiare dhe asistencë teknike nga aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës) dhe donatorët. Kjo mbështetje e jashtme është e nevojshme për shkak të tarifave aktuale të ulëta, të cilat nuk mund të mbulojnë në mënyrë adekuate investimet kapitale afatgjata të kërkuara për operacione të qëndrueshme të ndërmarrjes.

Ky Plan Biznesi është formuluar për të lehtësuar planifikimin dhe ekzekutimin financiar për vitet 2024-2026, i ankoruar në parametrat financiarë më realistë që përfshijnë të ardhurat dhe shpenzimet. PB harmonizohet me dokumentet strategjike shtetërore, duke përfshirë:

- 1.Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë (2021-2030) dhe Plani i Veprimit përkatës (2024-2026) dhe strategjia paraprake,
- 2.Projeksionet e investimeve të ekstrapuluara nga studimet e fizibilitetit për KMDK Sh.A. për periudhën 2024-2026,
- 3.Draft-Raporti Final i studimit të fizibilitetit për menaxhimin e mbetjeve të ngurta, Programi II, Kosovë (gusht 2022).

Ky plan është hartuar me përpikëri, duke u mbështetur në të dhënat analitike, krahasimet historike dhe statusin aktual operacional të kompanisë. PB është përpiluar për të inkorporuar standardet e industrisë dhe praktikat më të mira për të arritur misionin e kompanisë për zhvillim të qëndrueshëm.

Për më tepër, vlen të theksohet se ky Plan Biznesi është i adaptueshëm, me parashikime për një rishikim vjetor për të siguruar përputhshmëri me nevojat në zhvillim të Kompanisë dhe në përputhje me rregulloret ligjore në zhvillim e sipër dhe implementimin e projekteve investive nga donatorët.

# 1. Rreth KMDK-së



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është shoqëri aksionare (me shkurtime KMDK SH.A) e themeluar në kuadër të Ligjit për Ndërmarrjet Publike. KMDK SH.A është regjistruar me Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve si Shoqëri Aksionare me 100% pronësi të Qeverisë së Republikës së Kosovës, në përputhje me Ligjin Nr. 06/L-016 për Shoqëritë Tregtare. Kompania kryen aktivitetet e saj në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi, aktet ligjore të brendshme dhe dokumentet strategjike.

Kompania u themelua në vitin 2005 nëpërmjet bashkëpunimit të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare, ndërsa deponitë u ndërtuan nga Agjencia Evropiane për Rindërtim (AER). Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë është kompania qendrore për menaxhimin e deponive në nivel vendi.

Funksionimi dhe menaxhimi i deponive sanitare janë të lidhura ngusht me respektimin dhe zbatimin e rregullave dhe kriterëve mjedisore, siç janë paraparë në dispozitat ligjore përkatëse. Kompania synon të avancojë në vazhdimësi kujdesin për mjedisin në çdo aspekt të operacioneve të saj.

# 2. Deklarata e politikës

Synojmë të ofrojmë shërbime cilësore të menaxhimit të deponive sanitare dhe të trajtimit të mbeturinave duke u përpjekur që:

- Të aplikojmë qeverisje cilësore korporative në përputhje me Kodin e Etikës për Qeverisjen Korporative dhe bazën ligjore me synim të:
  - Arritjes së sigurisë dhe stabilitetit financiar,
  - Ofrimit të qasjes transparente në afarizmin e kompanisë,
  - Aplikimit të standardeve të avancuara në menaxhimin financiar dhe operacional.

---

- Të implementojmë strategjinë kombëtare për menaxhimin e integruar të mbeturinave, përfshirë ekonominë qarkore. Të bëjmë trajtimin profesional të mbeturinave për të siguruar shëndetin dhe pastërtinë në Republikën e Kosovës.

---

- Të rrisim dhe intensifikojmë bashkëpunimin me klientët duke iu përshtatur nevojave të tyre.

---

- Të kontribuojmë në vetëdijësimin dhe edukimin publik për trajtimin e përgjegjshëm të mbeturinave në Republikën e Kosovës, përfshirë luftimin e hedhjes ilegale të mbeturinave dhe deponive ilegale.

---

- Të implementojmë Qëllimet e Zhvillimit të Qëndrueshëm (SDG) si më poshtë:
  - Qytetet dhe Komunitetet e Qëndrueshme (SDG 11): synojmë të ofrojmë shërbime cilësore të trajtimit dhe deponimit të mbeturinave për qytetarët, duke mundësuar qytete dhe komunitete të qëndrueshme në Republikën e Kosovës, duke ulur ndikimin negativ ambiental për kokë banori në vendbanime.
  - Prodhimi dhe Konsumimi i Përgjegjshëm (SDG 11): synojmë të kontribuojmë në uljen e gjenerimit të mbeturinave duke parandaluar, reduktuar, ricikluar dhe ripërdorur.
  - Teknologjitë e Fundit për Trajtimin e Mbeturinave (SDG 9): synojmë të aplikojmë teknologjitë më të fundit inovative për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave.
  - Veprimi për Klimën (SDG 13): Synimi ynë është të kontribuojmë në veprimet për klimën duke ofruar zgjidhje të favorshme për mjedisin për menaxhimin e mbeturinave dhe duke minimizuar ndikimin ambiental të mbeturinave.

---

- Të krijojmë dhe mirëmbajmë raporte me ndërmarrjet simotra në rajon dhe botë për të siguruar shkëmbimin e përvojave dhe teknologjive.

## 2.1 Vizioni

Të jemi lideri kryesor në menaxhimin e sistemit të integruar të mbeturinave dhe ekonomisë qarkore, të dalluar për angazhimin tonë të palëkundur për profesionalizëm, transparencë dhe mbrojtje të mjedisit. Të japim kontribut qendror në uljen e ndikimit negativ të mbeturinave në mjedis dhe njëkohësisht të zgjerojmë aktivitetet tona duke krijuar mundësi të reja biznesi dhe punësimi. Ne do ta arrijmë këtë vizion duke aplikuar teknologjitë më të avancuara, duke ofruar shërbime superiore dhe duke vendosur standardet më të larta për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave.

## 2.2 Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë shërbime profesionale, transparente të menaxhimit të mbeturinave dhe deponive që kanë prioritet mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit. Ne përpiqemi të aplikojmë teknologji moderne që përmirësojnë operacionet tona dhe na mundësojnë të ofrojmë shërbime me cilësi të lartë. Përkushtimi ynë ndaj përsosshmërisë siguron se ne do të bëhemi pikë referimi për menaxhimin e qëndrueshëm të mbeturinave duke kontribuar për një të ardhme më të pastër dhe më të gjelbër për të gjithë.

# 3. Veprimtaria e kompanisë

Kompania jonë aktualisht ofron shërbime të menaxhimit të deponive sanitare. Kompania synon të zgjerojë gamën e shërbimeve duke përfshirë trajtimin e mbeturinave të pranura dhe shërbimin e kujdesit të deponive sanitare pas mbylljes. Ne operojmë brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi.

Për të siguruar veprimtari të qëndrueshme dhe në përputhje me standardet e nevojshme, kompania synon të pajiset me lejet, autorizimet, licencat dhe miratimet administrative të kërkuara për këto lloje të veprimtarive. Përmeshja e këtyre detyrave është një përgjegjësi që trajtohet me kujdes dhe profesionalizëm, pasi është thelbësore për të garantuar që operacionet tona janë të rregullta dhe të sigurta.

Gjithashtu, synojmë të intensifikojmë aktivitetet dhe investimet për trajtimin e mbeturinave në mënyrë që respekton mjedisin. Kjo përfshin menaxhimin e deponive, shërbimet pas mbylljes së tyre, dhe trajtimin e mbeturinave që pranojmë. Synojmë të aplikojmë teknologjitë më të fundit dhe metodat e trajtimit inovativ për të garantuar që mbeturinat trajtohen në mënyrë të përgjegjshme, dhe për të promovuar ripërdorimin dhe riciklimin sa më shumë që të jetë e mundshme.

## KMDK si veprimtari primare e ka:

- 3900 Aktivitetet e riparimit dhe shërbimet e tjera të menaxhimit të mbeturinave.

## Aktivitetet sekondare:

- 3811 Grumbullimi i mbeturinave jo të rrezikshme,
- 3821 Trajtimi dhe asgjësimi i mbeturinave jo të rrezikshme,
- 7511 Veprimtaria e shërbimeve të përgjithshme publike,
- Shërbimi i deponimit të mbeturinave Komunale në Deponitë Sanitare regjionale.

## Kompania menaxhon me katër deponi sanitare dhe një stacion transferi:

- Deponia Sanitare e Mirashit – Prishtinë,
- Deponia Sanitare e Landovicës – Prizren,
- Deponia Sanitare e Velekincës – Gjiilan,
- Deponia Sanitare e Dumnicës – Podujevë,
- Stacionin e Transferit në Gërlicë – Ferizaj.

# 4. Kufizimet dhe rreziqet

Gjatë hartimit të Planit të Biznesit të KMDK-së, kujdes i veçantë u është kushtuar kufizimeve dhe rreziqeve që mund të ndikojnë në realizimin e synimeve dhe objektivave të planifikuara. Këto kufizime dhe rreziqe shpërfaqen në formën e zhvillimeve, faktorëve direktë dhe indirektë, të cilët kanë lidhje me veprimtarinë e kompanisë:

## 1. Mos-Finalizimi i Përcaktimit të Lokacionit të DS Qendër

Mos finalizimi i caktimit të lokacionit të ri për ndërtimin e deponisë së re sanitare do të paraqiste sfida të jashtëzakonshme në aspektin logjistik dhe financiar të ndërmarrjes. Aktualisht, ky proces është në fazën e zhvillimit në bashkëpunim me institucionet qendrore dhe lokale.

## 2. Mosndërtimi i sistemit dhe metodologjisë së përcaktimit të tarifës

Aktualisht nuk ekziston baza rregullative adekuate që përcakton metodologjinë dhe autoritetin e pavarur për vlerësimin periodik të nivelit të tarifës hyrëse. Tarifa aktuale e përcaktuar (8.31€ + TVSH) është e ulët dhe nuk reflekton kostot reale të trajtimit të mbeturinave. Ndërtimi i metodologjisë së vlerësimit dhe përcaktimi i një autoriteti të pavarur rregullator për përcaktimin e tarifës do të sigurojë që KMDK SH.A të ketë stabilitet financiar dhe të mundësojë mbulimin e shpenzimeve operative, si dhe të planifikojë dhe realizojë projekte investuese për përmirësimin e trajtimit të mbeturinave sipas standardeve të kërkuara.

## 3. Risqet në tranzicion

Deponitë sanitare aktualisht janë në fazën e fundit të jetëgjatësisë së tyre. Për të përmbushur standardet europiane të menaxhimit të deponive sanitare janë planifikuar investime kapitale, të cilat pritet të kryhen me mbështetjen KfW-së, BE-së dhe Qeverisë së Kosovës. Sidoqoftë, disa nga rreziqet potenciale në procesin e tranzicionit nga deponitë e tanishme, derisa të ndërtohen deponitë e reja përfshijnë:



- Fatkeqësitë natyrore,
- Rrezikun e fundosjes së deponisë në Mirash,
- Rrezikun nga eksplozimet potenciale dhe shfaqja e zjarreve,
- Rrëshqitjet e skarpateve të mbeturinave,
- Rrjedhjet e mundshme të ujërave të zeza,
- Rreziku permanent nga ndërhyrja dhe prezenca e personave të pautorizuar në DS Velekincë,
- Kontestet juridike,
- Rreziku potencial i cili mund të shkaktojë aksident ekologjik është "liqeni" i krijuar si pasojë e zgjedhjes së gabuar të lokacionit për ndërtimin e DS Mirash, si dhe pamundësia e menaxhimit dhe trajtimit të ujërave të zeza në këtë deponi. KMDK SH.A, këtë rrezik e ka adresuar tek Aksionari.

#### 4. Rreziku Financiar

Mospagesa e borxheve nga klientët.

#### 5. Amortizimi i Makinerisë

Kompania posedon mekanizëm të pakët dhe një pjesë e konsiderueshme e makinerisë ekzistuese ka kaluar shkallën e amortizimit që vë në rrezik aftësinë e kompanisë për të përmbushur detyrat e veta operative përgjatë tranzicionit.

#### 6. Deponitë Ilegale

Prania e deponive ilegale paraqet një sfidë potenciale që mund të ndikojë në sasinë e mbeturinave të deponuara në deponitë sanitare dhe të ulë të ardhurat e planifikuara si dhe të ndikojë negativisht në mjedis në një shkallë të paparashikueshme.

#### 7. Emigracioni

Parashikimi që pas liberalizimit të vizave Schengen mund të ketë rritje të emigracionit drejt vendeve të BE-së.

# 5. Orientimi strategjik

Kompania është e përkushtuar në zhvillimin e qëndrueshëm të saj dhe në zgjerimin e veprimtarisë së saj në fushën e trajtimit të mbeturinave. Orientimi ynë strategjik përfshin përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të organizatës, zhvillimin e shërbimeve të reja dhe minimizimin e risqeve.

Kompania është në fazën e investimeve nga KfW, BE dhe Qeveria e Kosovës, për çfarë është kryer një studim fizibiliteti në të cilin përfshihen investime në ndërtimin e kapaciteteve të reja deponuese në shumën prej 53 milionë euro. Në fazën e parë (2023-2027) është paraparë investimi në shumën prej: 39,336,608.00 €.

## Investimet dhe financimi i PIP 2023-2027, Faqe 228, e Draft - Raportit (gusht 2022)

Artikulli	2023	2024	2025	2026	2027	TOTALI
<b>INVESTIMET E PROJEKTIT</b>						
Deponia e Re në Prishtinë	425,000	5,463,845	8,353,391	50,000	0	14,292,236
Zgjerimi DS Prizren	330,000	2,216,839	8,443,299	30,000	0	11,020,138
Zgjerimi DS Gjilan	320,000	2,226,459	8,138,046	30,000	0	10,714,505
Mbyllja e DS Podujevë	0	0	0	324,098	1,534,365	1,858,462
Përmirësimi i ST Ferizaj	45,000	188,076	1,208,190	10,000	0	1,451,267
<b>Kostot totale të investimit PIP</b>	<b>1,120,000</b>	<b>10,095,219</b>	<b>26,142,927</b>	<b>444,098</b>	<b>1,534,365</b>	<b>39,336,608</b>
<b>FINANCIMI I PROJEKTIT</b>						
Donacion i KfW	1,120,000	10,095,219	26,142,927	444,098	1,534,365	39,336,608
<b>Kapitali Vetanak</b>						
<b>Totali i financimit</b>	<b>1,120,000</b>	<b>10,095,219</b>	<b>26,142,927</b>	<b>444,098</b>	<b>1,534,365</b>	<b>39,336,608</b>

KMDK gjatë vitit 2024 do të përfitojë mbështetjen profesionale nga dy projekte mbështetëse. Projekti për masat zbatuese do të angazhohet për implementimin e projektit. Paralelisht, projekti për masat shoqëruese do të angazhohet për mbështetjen teknike për KMDK-në. Projekti do të mbështesë ndërmarrjen në realizimin e ristrukturimit sipas gjetjeve të studimit të fizibilitetit të kryer për këtë projekt.

KMDK është e vetëdijshme që me avancimin e menaxhimit të integruar të mbeturinave, pritet rënie e vazhdueshme e sasive të mbeturinave për deponim. Prandaj, KMDK synon të pozicionohet në ofrimin e shërbimeve shtesë në procesin e menaxhimit të integruar të mbeturinave. Me këtë synim, Kompania do të organizojë studime fizibiliteti për aktivitetet e reja potenciale si në vijim:

- Vlerësimi i opsioneve për fillimin e ndarjes së mbeturinave në deponi;
- Vlerësimi i opsioneve për zgjerimin e aktiviteteve në fushën e trajtimit mekanik-biologjik të mbeturinave;
- Vlerësimi i opsioneve për trajtimin e mbetjeve të pariciklueshme;
- Vlerësimi i opsioneve për kompostim të mbeturinave të gjelbërta;
- Vlerësimi i opsioneve për rolin e KMDK-së në implementimin e përgjegjësive të zgjeruara të prodhuesit.

KMDK ende nuk mbulon tërë territorin e Kosovës dhe një numër i deponive nuk janë nën menaxhimin e saj. Kompania do të përgatitet për përvetësimin potencial të deponive të tjera.

KMDK do të intensifikojë agazhimin për të dhënë kontributin e saj në zhvillimin e bazës ligjore dhe rregullative në Kosovë sa i përket menaxhimit të integruar të mbeturinave.

Kompania do të jetë e hapur për partneritete potenciale me sektorin privat për të përshpejtuar arritjen e objektivave të saj. Me këtë synim, do të ndërtohet strategji për angazhim transparent për bashkëpunim me këtë sektor. Gjithashtu, KMDK synon të rrisë bashkëpunimin me organizatat e shoqërisë civile dhe të komunitetit, me synim të gjithëpërfshirjes në menaxhimin e integruar të mbeturinave.

KMDK synon të rrisë angazhimin publik për rritjen e vetëdijësimit publik për luftimin e hedhjes ilegale të mbeturinave dhe deponive ilegale.

# 6. Objektivat e KMDK-së

## **Modernizimi dhe avancimi i burimeve njerëzore dhe përqendrimi në kujdesin ndaj klientit**

Ne kemi në qendër të strategjisë sonë përmirësimin e aftësive të ekipit tonë për të arritur objektivat e ndërmarrjes. Njëkohësisht, planifikojmë rritjen e kujdesit ndaj nevojave të klientëve tanë, për të siguruar shërbime me cilësi të lartë dhe marrëdhënie afatgjata me ta.

## **Mirëmbajtja e kapacitetit ekzistues të deponimit të mbeturinave si dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit dhe menaxhimit të qëndrueshëm të deponive ekzistuese sanitare dhe stacionit të transferit të mbeturinave**

Synojmë të mirëmbajmë kapacitetin ekzistues të deponimit dhe të përmirësojmë cilësinë e shërbimit në deponitë ekzistuese gjatë tranzicionit deri në ndërtimin e deponive të reja moderne, duke përdorur metoda të përmirësuara të menaxhimit të mbeturinave dhe duke u kujdesur për mbrojtjen e mjedisit dhe përmirësuar shërbimet.

## **Planifikimi dhe ngritja e kapaciteteve të reja moderne të deponimit dhe dizajnimi i shërbimeve shtesë të trajtimit të mbeturinave**

Synojmë të planifikojmë, realizojmë ndërtimin e kapaciteteve të reja moderne të deponimit. Paralelisht, planifikojmë dizajnimin e shërbimeve të reja të trajtimit të mbeturinave bazuar në praktikën më të mirë, me qëllim të ofrimit të zgjidhjeve praktike dhe ekologjike të trajtimit të mbeturinave në vend dhe njëkohësisht diversifikimin dhe rritjen e të hyrave për ndërmarrjen tonë.

## **Përmirësimi i shkallës së inkasimit përmes masave të ndryshme**

Punojmë në ngritjen e efikasitetit të procesit të inkasimit të borxheve duke zhvilluar dhe mirëmbajtur raportet me klientët tanë por gjithashtu duke përfshirë masat administrative dhe ligjore për menaxhimin e borxheve, dhe për të siguruar që të drejtat tona janë të mbrojtura. Masat administrative si ndërprerja e shërbimeve, aplikimi i kamatë-vonesave, ristrukturimi i borxheve sipas kuadrit ligjor dhe nisja e procedurave përmbartimore dhe gjyqësore, do të sigurojnë që të përmirësohet inkasimi i borxheve.

---

## **Problemet financiare të klientëve dhe ndikimi në inkasimin e borxheve**

Ne kemi për qëllim të përmirësojmë komunikimin me klientët dhe të ofrojmë zgjidhje të personalizuara për këto probleme.

---

## **Makineria e pamjaftueshme për trajtimin e mbeturinave**

Investimet në makineri të re dhe teknologji moderne janë të nevojshme për të përmirësuar efikasitetin e trajtimit të mbeturinave dhe për të përcaktuar një standard më të lartë.

---

## **Ristrukturimi i kompanisë**

Investimet e mëdha të planifikuara me mbështetjen e donatorëve kërkojnë edhe ristrukturimin e kompanisë për të qenë e gatshme të implementojë investimet dhe të sigurojë efektivitet dhe efikasitet pas përfundimit të investimeve.

---

## **Tarifat e Aplikuara dhe Shpenzimet Tatimore**

Duam të sigurojmë që tarifat të jenë të rregulluara në mënyrë që të reflektojnë shpenzimet reale dhe të përmirësojnë qëndrueshmërinë financiare të kompanisë.

---

## **Mungesa e dixhitalizimit**

Mungesa e dixhitalizimit i krijon kompanisë mangësi të theksuara në rritjen e efikasitetit dhe përmirësimin e mbikëqyrjes së operacioneve.

---

Në një mjedis të këtyre sfidave, ne kemi përqendruar orientimin tonë strategjik në përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të organizatës sonë për të ofruar shërbime më të mira dhe për të minimizuar rreziqet që mund të ndikojnë në qëllimet tona të zhvillimit dhe shërbimit ndaj klientëve.

# 8. Analiza SWOT

## Përparësitë

- Kompania e vetme qëndrore për menaxhimin e deponive në vend.
- Traditë e gjatë e shërbimeve të ofruara, afër 18 vite.
- Ofrues profesional i shërbimeve të trajtimit të mbeturinave.
- Menaxhment i ri. Vlerësimi pozitiv për shërbimet e ofruara nga klientët.

## Mundësitë

- Ndërtimi i kapaciteteve të reja moderne.
- Ndërtimi i sistemit të avancuar të menaxhimit të burimeve njerëzore.
- Mundësia e zgjerimit në tërë territorin e Republikës së Kosovës.
- Mundësia e zgjerimit të aktiviteve në trajtimin e mbeturinave.
- Rritja e cilësisë dhe efikasitetit të shërbimeve të ofruara.
- Zvogëlimi i shpenzimeve.
- Modernizimi dhe digjitalizimi i shërbimeve.


## Dobësitë

- Mungesa e lejeve dhe pëlqimeve institucionale.
- Tarifa aktuale e ulët.
- Borxhet e akumuluar.
- Mungesa e burimeve financiare për zëvendësimin e aseteve të amortizuara.
- Mungesa e ndërtesës administrative.
- Mungesa e elektrifikimit në DS Podujevë.

## Rreziqet

- Fundosja e DS Mirash.
- Afrimi i afatit të mbylljes së Deponive.
- Kontesti eventual për lokacionin e DS të re.
- Aksidentet ekologjike.
- Shfaqja e zjarreve dhe eksplozimet e mundshme në DS.
- Incidentet dhe aksidentet e mundshme për shkak të qasjes së personave të pa-autorizuar në DS.
- Ndërhyrjet e jashtme në kompani.
- Emigrimi i stafit.

## 9. Organogrami aktual\*



\*Organogrami aktual si është regjistruar nga studimi i fizibilitetit.

# 9.1 Numri i të punësuarve dhe struktura gjinore

	Struktura	Numri i Punëtorëve
<b>1.</b>	Administrata Qendrore	<b>29</b>
<b>1.1</b>	Femra	<b>14</b>
<b>1.2</b>	Meshkuj	<b>15</b>
<b>1.2.1</b>	Me nevoja te veçanta	<b>1</b>
<b>2.</b>	Operativa - Deponitë Sanitare (teknikët, kontrollorët, sigurimi, mirëmbajtësja)	<b>63</b>
<b>2.1</b>	Femra	<b>2</b>
<b>2.2</b>	Meshkuj	<b>61</b>
<b>2.2.1</b>	Nevoja te veçanta	<b>1</b>
<b>Nr total</b>		<b>92</b>

Struktura gjinore në Operativë është e tillë për shkak të natyrës specifike të punës.



# 10. Menaxhimi i burimeve njerëzore

Krahas ristrukturimit organizativ, në përputhje me të gjeturat e studimit të fizibilitetit, ndërmarrja jonë synon të ndërtojë një model të avancuar të menaxhimit të burimeve njerëzore të bazuar në tre faza kyçe:

## 1. Caktimi i Objektivave

- Proces bashkëpunues për vendosjen e objektivave SMART për secilin punonjës.
- Përputhja e objektivave individuale me synimet dhe vlerat organizative.
- Dokumentimi i pajtuar në Planin e Caktimit të Objektivave.

## 2. Vlerësimi i Performancës

- “Feedback” i vazhdueshëm gjatë ciklit të performancës.
- Rishikim në mes të ciklit për të vlerësuar progresin.
- Vlerësim në fund të vitit për të vlerësuar arritjet.
- Vlerësimi i performancës për mundësi zhvillimi.

## 3. Plan Zhvillimi Profesional

- Analiza e hendekut të shkathtësive dhe identifikimi i fushave për përmirësim.
- Plan Zhvillimi Profesional individual.
- Përcaktimi i burimeve për zhvillimin e shkathtësive.
- Monitorimi i rregullt i progresit të planit.
- Diskutime për rrugën profesionale për avancim profesional afatgjatë.
- Modeli i Burimeve Njerëzore do të synojë promovimin e rritjes profesionale të punonjësve, përputhjen e qëllimeve dhe ndërtimin e një kulture të përmirësimit të vazhdueshëm, duke u siguruar që punonjësit kanë mbështetjen adekuate për të shkëlqyer në rolet e tyre.
- Menaxhmenti do të identifikojë nevojat dhe kërkesat për avancim të mëtutjeshëm profesional të stafit sipas natyrës së punës (si ndryshimi i legjislacionit, zhvillimet teknologjike dhe mekanike etj.).

# 10.1 Rekrutimi i stafit

FAQE 18

Gjatë vitit 2024, bazuar në Rregulloren e Brendshme për Procedurën e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e Vendit të Punës në KMDK, dhe në përputhje me Planin e Biznesit, synojmë të plotësojmë pozitat e lira si në vijim:

- 1. Inxhinier: 4 pozita,**
- 2. Zyrtar i ligjshmërisë: 1 pozitë**
- 3. Shofer kamioni: 1 pozitë në ST Ferizaj.**



# 11. Projektioni për Sasitë e Mbeturinave 2024, 2025 dhe 2026

FAQE 19

## Sasia e mbeturinave Amvisëri nga KRM –të dhe Klientët Privatë e paraqitur në Planin e Biznesit 2024

Deponitë	Mirash			Landovicë			Velekinçë			Dumnicë			Gëriticë			Përmbledhje		
	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total
<b>Janar</b>	12,869.68	1,871.68	14,741.36	8,965.76	584.67	9,550.43	3,448.48	88.85	3,537.33	1,412.25	52.92	1,465.17	1,141.25	560.70	1,701.95	29,229.29	3,316.76	32,546.05
<b>Shkurt</b>	10,802.19	1,874.28	12,676.47	6,911.95	445.18	7,357.13	2,801.94	62.35	2,864.28	1,151.64	47.46	1,199.10	759.05	462.42	1,221.47	23,548.10	3,036.27	26,584.37
<b>Mars</b>	13,726.17	2,401.15	16,127.32	8,537.82	492.56	9,030.38	3,329.70	70.10	3,399.80	1,318.28	244.55	1,562.82	939.86	546.63	1,486.49	29,244.41	3,942.73	33,187.14
<b>Prill</b>	12,736.65	2,051.12	14,787.77	8,173.61	518.16	8,691.77	3,253.74	79.28	3,333.02	1,281.32	44.73	1,326.05	1,009.81	559.55	1,569.35	27,777.87	3,415.48	31,193.35
<b>Maj</b>	13,575.60	2,509.12	16,084.72	9,492.27	537.42	10,029.69	3,912.48	94.41	4,006.88	1,495.10	52.71	1,547.81	1,420.76	633.78	2,054.54	31,391.01	4,018.81	35,409.82
<b>Qershor</b>	14,089.19	2,293.34	16,382.53	9,141.77	505.73	9,647.51	3,682.76	73.04	3,755.80	1,348.22	49.83	1,398.05	1,327.73	581.07	1,908.80	31,069.16	3,678.16	34,747.32
<b>Korrik</b>	14,072.96	2,494.94	16,567.90	10,650.42	705.95	11,356.37	4,252.17	263.76	4,515.93	1,554.32	120.98	1,675.30	2,135.99	683.22	2,819.22	34,299.16	4,482.29	38,781.45
<b>Gusht</b>	14,573.31	2,651.93	17,225.24	12,493.24	976.40	13,469.63	5,301.31	243.81	5,545.12	1,788.15	144.06	1,932.21	2,631.89	744.56	3,376.44	38,627.29	4,998.79	43,626.08
<b>Shtator</b>	13,165.32	2,215.56	15,380.88	9,908.83	649.95	10,558.78	3,745.27	154.14	3,899.41	1,366.16	111.41	1,477.56	1,659.42	540.65	2,200.07	31,337.24	3,855.29	35,192.53
<b>Tetor</b>	13,113.95	2,231.58	15,345.54	9,223.82	592.78	9,816.60	3,691.49	124.10	3,815.58	1,391.69	95.10	1,486.78	1,631.56	380.05	2,011.61	30,505.13	3,594.79	34,099.91
<b>Nëntor</b>	14,058.65	2,359.46	16,418.11	9,918.91	637.46	10,556.37	3,969.64	131.91	4,101.55	1,496.57	102.14	1,598.72	1,741.80	406.62	2,148.43	32,744.86	3,819.47	36,564.33
<b>Dhjetor</b>	17,277.24	2,950.70	20,227.94	12,142.18	780.33	12,922.51	4,859.46	163.86	5,023.31	1,832.00	125.24	1,957.24	2,151.89	500.97	2,652.85	40,175.90	4,747.14	44,923.04
<b>Total</b>	164,060.91	27,904.86	191,965.77	115,560.59	7,426.59	122,987.17	46,248.43	1,549.59	47,798.02	17,435.68	1,191.12	18,626.80	18,550.98	6,600.21	25,151.19	379,949.41	46,905.99	426,855.39

## Sasia e mbeturinave Amvisëri nga KRM-të dhe Klientët Privatë e paraqitur në Planin e Biznesit 2025

Deponitë	Mirash			Landovicë			Velekinçë			Dumnicë			Gëriticë			Përmbledhje		
	Sasi			Sasi			Sasi			Sasi			Sasi			Sasi		
	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total
<b>Janar</b>	13,513.17	1,965.26	15,478.43	9,414.05	613.91	10,027.95	3,620.91	93.29	3,714.20	1,482.86	55.57	1,538.43	1,198.31	588.74	1,787.04	29,229.29	3,316.76	32,546.05
<b>Shkurt</b>	11,342.30	1,968.00	13,310.30	7,257.55	467.44	7,724.99	2,942.03	65.47	3,007.50	1,209.22	49.83	1,259.06	797.00	485.54	1,282.54	23,548.10	3,036.27	26,584.37
<b>Mars</b>	14,412.48	2,521.21	16,933.68	8,964.71	517.18	9,481.90	3,496.18	73.60	3,569.78	1,384.19	256.77	1,640.96	986.85	573.96	1,560.81	29,244.41	3,942.73	33,187.14
<b>Prill</b>	13,373.48	2,153.68	15,527.16	8,582.29	544.07	9,126.36	3,416.43	83.24	3,499.67	1,345.38	46.97	1,392.35	1,060.30	587.52	1,647.82	27,777.87	3,415.48	31,193.35
<b>Maj</b>	14,254.38	2,634.58	16,888.95	9,966.89	564.29	10,531.18	4,108.10	99.13	4,207.23	1,569.85	55.35	1,625.20	1,491.79	665.47	2,157.26	31,391.01	4,018.81	35,409.82
<b>Qershor</b>	14,793.65	2,408.00	17,201.66	9,598.86	531.02	10,129.88	3,866.90	76.69	3,943.59	1,415.63	52.32	1,467.96	1,394.11	610.12	2,004.23	31,069.16	3,678.16	34,747.32
<b>Korrik</b>	14,776.61	2,619.68	17,396.29	11,182.94	741.24	11,924.19	4,464.78	276.95	4,741.73	1,632.03	127.03	1,759.06	2,242.79	717.39	2,960.18	34,299.16	4,482.29	38,781.45
<b>Gusht</b>	15,301.97	2,784.53	18,086.50	13,117.90	1,025.21	14,143.11	5,566.38	256.00	5,822.38	1,877.56	151.26	2,028.82	2,763.48	781.78	3,545.27	38,627.29	4,998.79	43,626.08
<b>Shtator</b>	13,823.59	2,326.34	16,149.93	10,404.27	682.45	11,086.72	3,932.53	161.85	4,094.38	1,434.46	116.98	1,551.44	1,742.39	567.68	2,310.07	31,337.24	3,855.29	35,192.53
<b>Tetor</b>	13,769.65	2,343.16	16,112.81	9,685.01	622.42	10,307.43	3,876.06	130.30	4,006.36	1,461.27	99.85	1,561.12	1,713.13	399.05	2,112.19	30,505.13	3,594.79	34,099.91
<b>Nëntor</b>	14,761.58	2,477.43	17,239.01	10,414.86	669.33	11,084.19	4,168.12	138.51	4,306.63	1,571.40	107.25	1,678.66	1,828.89	426.95	2,255.85	32,744.86	3,819.47	36,564.33
<b>Dhjetor</b>	18,141.10	3,098.24	21,239.33	12,749.29	819.35	13,568.63	5,102.43	172.05	5,274.48	1,923.60	131.50	2,055.10	2,259.48	526.01	2,785.49	40,175.90	4,747.14	44,923.04
<b>Total</b>	172,26.95	29,300.10	201,564.06	121,338.62	7,797.92	129,136.53	48,560.85	1,627.07	50,187.92	18,307.46	1,250.68	19,558.14	19,478.53	6,930.22	26,408.75	379,949.41	46,905.99	426,855.39

## Sasia e mbeturinave Amvisëri nga KRM-të dhe Klientët Privatë e paraqitur në Planin e Biznesit 2026

Deponitë	Mirash			Landovicë			Velekinçë			Dumnice			Gëriticë			Përmbledhje		
	Sasi			Sasi			Sasi			Sasi			Sasi			Sasi		
	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total
<b>Muaji</b>	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total	KRM	Privat	Total
<b>Janar</b>	14,188.82	2,063.52	16,252.35	9,884.75	644.60	10,529.35	3,801.95	97.96	3,899.91	1,557.01	58.34	1,615.35	1,258.22	618.17	1,876.39	30,690.76	3,482.60	34,173.36
<b>Shkurt</b>	11,909.41	2,066.40	13,975.81	7,620.43	490.81	8,111.24	3,089.13	68.74	3,157.87	1,269.68	52.32	1,322.01	836.85	509.82	1,346.67	24,725.50	3,188.09	27,913.59
<b>Mars</b>	15,133.10	2,647.27	17,780.37	9,412.95	543.04	9,955.99	3,670.99	77.28	3,748.27	1,453.40	269.61	1,723.01	1,036.19	602.66	1,638.85	30,706.63	4,139.86	34,846.49
<b>Prill</b>	14,042.15	2,261.36	16,303.52	9,011.40	571.28	9,582.68	3,587.25	87.40	3,674.65	1,412.65	49.31	1,461.96	1,113.31	616.90	1,730.21	29,166.77	3,586.25	32,753.02
<b>Maj</b>	14,967.10	2,766.31	17,733.40	10,465.23	592.51	11,057.74	4,313.51	104.08	4,417.59	1,648.34	58.11	1,706.46	1,566.38	698.74	2,265.12	32,960.56	4,219.75	37,180.31
<b>Qershor</b>	15,533.34	2,528.40	18,061.74	10,078.80	557.57	10,636.37	4,060.24	80.52	4,140.77	1,486.41	54.94	1,541.35	1,463.82	640.63	2,104.45	32,622.61	3,862.07	36,484.68
<b>Korrik</b>	15,515.44	2,750.67	18,266.11	11,742.09	778.31	12,520.40	4,688.02	290.80	4,978.82	1,713.63	133.38	1,847.01	2,354.93	753.26	3,108.19	36,014.12	4,706.41	40,720.52
<b>Gusht</b>	16,067.07	2,923.76	18,990.83	13,773.79	1,076.48	14,850.27	5,844.70	268.80	6,113.50	1,971.44	158.83	2,130.26	2,901.66	820.87	3,722.53	40,558.65	5,248.73	45,807.38
<b>Shtator</b>	14,514.77	2,442.66	16,957.42	10,924.48	716.57	11,641.05	4,129.16	169.94	4,299.10	1,506.19	122.82	1,629.01	1,829.51	596.06	2,425.57	32,904.10	4,048.05	36,952.15
<b>Tetor</b>	14,458.14	2,460.32	16,918.45	10,169.26	653.54	10,822.80	4,069.86	136.82	4,206.68	1,534.34	104.84	1,639.18	1,798.79	419.01	2,217.80	32,030.38	3,774.53	35,804.91
<b>Nëntor</b>	15,499.66	2,601.30	18,100.96	10,935.60	702.80	11,638.40	4,376.53	145.43	4,521.96	1,649.97	112.61	1,762.59	1,920.34	448.30	2,368.64	34,382.10	4,010.45	38,392.55
<b>Dhjetor</b>	19,048.15	3,253.15	22,301.30	13,386.75	860.31	14,247.06	5,357.55	180.65	5,538.20	2,019.78	138.07	2,157.85	2,372.45	552.31	2,924.77	42,184.69	4,984.50	47,169.19
<b>Total</b>	180,877.15	30,765.11	211,642.26	127,405.55	8,187.81	135,593.36	50,988.89	1,708.42	52,697.32	19,222.84	1,313.21	20,536.05	20,452.45	7,276.73	27,729.18	398,946.88	49,251.29	448,198.16

# 12. Projektioni financiar

FAQE 22

## Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2024-2026

Kategoritë (zërat) e të hyrave dhe shpenzimeve		Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2023	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2024	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2025	Planifikimi i të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2026
<b>Sektori I</b>	<b>I - TË HYRAT</b>				
<b>A</b>	1. Të hyrat nga Amvisëria - KRM-të	2,362,826.00	2,991,473.11	3,519,030.74	4,051,890.17
	2. Të hyrat nga Amvisëria - Privat	295,339.00	359,166.71	377,125.04	476,878.03
	3. Të hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuarat - KRM	180,000.00	108,192.73	128,932.79	151,476.38
	4. Të hyrat nga mbetjet shtazore dhe mbeturinat e asgjësuarat - Privat	35,000.00	83,887.71	99,968.61	117,447.88
	<b>Totali i të hyrave nga Aktiviteti Kryesor (1+2+3+4)</b>	<b>2,873,165.00</b>	<b>3,542,720.27</b>	<b>4,125,057.18</b>	<b>4,797,692.46</b>
<b>B</b>	5. Të hyrat Tjera		12,000.00	13,800.00	15,870.00
	<b>Totali i të hyrave operative (1+2+3+4+5)</b>	<b>2,873,165.00</b>	<b>3,554,720.27</b>	<b>4,138,857.18</b>	<b>4,813,562.46</b>
	<b>6. Inkasimi nga marrëveshjet e ri-programimeve</b>	<b>254,927.00</b>	<b>254,927.00</b>	<b>254,927.00</b>	<b>254,927.00</b>
<b>C</b>	7. Të hyrat e pritura nga procedurat gjyqësore dhe përmbarimore	0.00	2,500.00	8,500.00	2,000.00
	<b>Totali i të hyrave tjera (6+7)</b>	<b>254,927.00</b>	<b>257,427.00</b>	<b>8,500.00</b>	<b>2,000.00</b>
<b>Ç</b>	<b>Totali i të hyrave (sek. B+C)</b>	<b>3,128,092.00</b>	<b>3,812,147.27</b>	<b>4,147,357.18</b>	<b>4,815,562.46</b>

II- SHPENZIMET	2023	2024	2025	2026
8. Pagat bazë*	688,520.92	723,941.73	738,420.56	753,188.97
9. Përvoja e punës sipas koeficientit 0.05% për vit pune	45,600.00	46,055.00	46,976.10	47,915.62
10. Shujta	87,780.00	99,792.00	101,787.84	103,823.60
11. Kompenzime tjera (orët jashtë orari, pagat jubilarë, kompenzimet për pensionim, kontrata specifike, praktikantë etj.)	41,954.00	52,184.00	53,227.68	54,292.23
<b>12. Kontributet pensionale 5% nga Punëdhënësi</b>	<b>43,192.75</b>	<b>46,098.64</b>	<b>47,020.61</b>	<b>47,961.02</b>
13. Sigurimet shëndetësore - Punëdhënësi	7,802.33	25,337.96	25,844.72	26,361.61
14. Paga dhe kontribute - Bordi i Drejtorëve	33,264.00	33,264.00	33,264.00	33,264.00
15. D.D.D	75,000.00	75,000.00	80,000.00	85,000.00
16. Furnizimi me dru për ngrohje	7,500.00	7,500.00	8,000.00	8,500.00
17. Angazhimi i OE për trajtimin e ujërave të zeza në kolektor STF	17,500.00	17,500.00	20,000.00	22,500.00
18. Kontraktimi i Makinerisë për shtyerje mbeturinave trajtim të mbeturinave, rregullim të skarpateve në formë piramide për rritjen e jetëgjatësive të Deponive	50,000.00	50,000.00	60,000.00	70,000.00
19. Furnizim me dhe dhe mbulimi i mbeturinave	80,000.00	80,000.00	110,000.00	130,000.00
20. Funkcionalizimi i pompave nëpër DS, dhe instalimeve elektrike në panele, sistemeve riqarkulluese të ujërave	18,000.00	18,000.00	20,000.00	22,000.00
21. Shërbime transporti për ngarkim dhe bartje të mbeturinave në STF	125,000.00	9,900.00	9,900.00	9,900.00
22. Shpenzimet e riparimit mirëmbajtje e mak. rëndë	145,000.00	145,000.00	160,000.00	165,000.00
23. Furnizimi dhe servisimi i aparateve kundër zjarrit	12,875.00	12,875.00	12,875.00	12,875.00
24. Shpenzimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së automjeteve	12,725.00	5,000.00	6,000.00	7,000.00
25. Shpenzimet për derivate të naftës	295,000.00	351,000.00	394,800.00	402,696.00

D

	26. Shpenzimet për vajra	30,000.00	30,000.00	30,000.00	30,000.00
	27. Shpenzimet për filtra	16,950.00	16,950.00	16,950.00	16,950.00
	28. Servisimi dhe kalibrimi i njëhësorëve të naftës	850.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	29. Servisimi, kalibrimi dhe mirëmbajtja e peshoreve ekzistuese	12,000.00	4,600.00	4,600.00	4,600.00
	30. Furnizimi me goma për makineri dhe automjete	22,000.00	22,000.00	22,000.00	22,000.00
	31. Shërbime të sallimit për Kontejner në STF	4,000.00	1,000.00	1,000.00	1,000.00
	32. Shpenzimet për kryerjen e analizave të ujit në Lagunat e DS-ve	10,000.00	15,000.00	25,000.00	35,000.00
	33. Shpenzimet administrative	196,048.00	149,598.00	157,077.90	164,931.80
D	34. Shpenzimet e shërbimeve të trajnimeve		6,000.00	7,000.00	8,000.00
	35. Shpenzimet shërbimeve të udhëtimit	28,000.00	12,000.00	15,000.00	18,000.00
	36. Shpenzimet e Shërbimeve të konsulencës		10,000.00	15,000.00	20,000.00
	37. Shpenzimet e Reprerentacionit dhe përfaqësimit	9,200.00	10,500.00	12,000.00	13,500.00
	38. Shpenzimet e zhvendosjes dhe bartjes së inventarit	0.00	2,500.00	0.00	0.00
	39. Shpenzimet e suvatimit dhe kthimit në gjendjen fillestare të objektit	0.00	9,500.00	0.00	0.00
	40. Të paparashikuara	68,900.00	120,000.00	120,000.00	120,000.00
	41. Auditimi i pasqyrave financiare	1,100.00	4,000.00	2,500.00	2,500.00
	42. Shërbime të konsulencës juridike	0.00 €	20,000.00	20,000.00	20,000.00
	<b>Totali i shpenzimeve operative (SEK.D)</b>	<b>2,185,762.00</b>	<b>2,233,096.33</b>	<b>2,377,244.41</b>	<b>2,479,759.86</b>
	<b>III. Fitimi operativ para Zhvlerësimit (Ç-D)</b>	<b>942,330.00</b>	<b>1,579,050.94</b>	<b>1,770,112.77</b>	<b>2,335,802.60</b>
	<b>IV. Amortizimi-Shpenzimet e zhvlerësimit</b>	<b>717,900.00</b>	<b>720,497.00</b>	<b>900,497.00</b>	<b>952,497.00</b>
DH	<b>V. Fitimi/Humbja para të hyrave jo operative (III-IV)</b>	<b>224,430.00</b>	<b>858,553.94</b>	<b>869,615.77</b>	<b>1,383,305.60</b>
	<b>VI. Të hyrat jo operative</b>	<b>39,158.00</b>	<b>39,158.00</b>	<b>39,159.00</b>	<b>39,160.00</b>
	<b>VIII. Fitimi/Humbja e vitit para tatimit: (V-VI-VII)</b>	<b>263,588.00</b>	<b>897,711.94</b>	<b>908,774.77</b>	<b>1,422,465.60</b>



Kompania synon që të mbulojë kostot operative në përjashtim të amortizimit me të ardhura nga të hyrat vetanake (shih projeksionet financiare në Tabelë.)

II.1.Paga bazë\* nënkupton: paga bazë sipas Kontratës.

II.15.Shpenzimet administrative\* nënkuptojnë: (Qiraja për zyre bruto / Shpenzime të telefonisë mobile / Shpenzime të internetit dhe telefonisë fikse / Shpenzime për energjinë elektrike / Shpenzime të ujit dhe mbeturinave / Shpenzimet për materialin hargjues për zyre / Shpenzimet për veshmbathje (pajisjet mbrojtëse) për punëtorë / Shpenzime për inventar / Shpenzime për mirëmbajtje të webfaqes / Shpenzime për publikim zyrtar (shpallje) / Shpenzime për materialin higjienik dhe ujë / Shpenzime për sigurim të automjeteve / Asocim në shoqata të biznesit / Bileta për udhëtime zyrtare / Shpenzime për sigurim të objektit / Raportit për kënaqësinë e konsumatorëve / Blloka për peshim për deponi / Shpenzime për marrje të veturave me qira / Shpërblime / Sigurim Shëndetësor) / Analizat për stafin / Dezinfektues / Vaksinim të punëtorëve, kontrolla sistematike.

II.23 Shpenzimet për kryerjen e analizave të ujit në Lagunat e DS-ve\*, Kjo çështje më saktësisht do të trajtohet te shërbimet e konsulencës.

**Plani i Aktiviteteve për Investime gjatë periudhës së vitit 2024**

Nr.	AKTIVITETET INVESTIVE	Planifikimi 2024	Planifikimi 2025	Planifikimi 2026
1	Investimet për pjesë rezervë (mirëmbajtja investive)	122,523.00	140,000.00	155,000.00
2	Blerje e makinerisë	250,000.00	200,000.00	300,000.00
3	Blerje e automjeteve (veturë)	45,000.00	30,000.00	-
4	Investimet në ndërtimin e kaskadave për formën piramidale në DS	575,000.00	632,500.00	695,750.00
5	Vegla pune për hortikulturë në DS	2,500.00	3,000.00	3,500.00
6	Furnizim me pajisje teknologjike	8,500.00	5,000.00	12,000.00
7	Inventar për zyre	5,000.00	3,000.00	5,000.00
8	Investime për programe kompjuterike	10,000.00	-	-
9	Furnizim me gjenerator	2,000.00	2,000.00	2,000.00
10	Furnizim me cisterna mobile	25,000.00	100,000.00	
11	Sistemet solare për Deponinë në Podujevë	10,000.00		
12	Aparat saldimi	2,000.00	-	-
13	Dixhitalizimi (Sistemi për evidentim dhe faturim dhe sistemi i burimeve njerëzore)	30,000.00	-	-
	<b>Totali i investimeve (1 deri 10)</b>	<b>1,087,523.00</b>	<b>1,115,500.00</b>	<b>1,173,250.00</b>

